

UDHËZIM
Nr. 8, datë 19.3.2024

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 19, DATË 22.11.2022,
“PËR TARIFAT E TË ARDHURAVE DYTËSORE TË APLIKUESHME NGA
INSTITUCIONET VARTËSE TË MINISTRISË SË BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës; të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar; të neneve 7, 44, 125, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të neneve 16, 18, 21, 24, 28, 33 dhe 37, të ligjit nr. 10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, të ndryshuar; të nenit 14, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar; të neneve 14 dhe 32, të ligjit nr. 8/2019, “Për skemat e cilësisë së produkteve ushqimore dhe bujqësore”; të ligjit nr. 87, datë 14.2.2013, “Për kategorizimin e prodhimit, emërtimin dhe tregtimin e vajit të ullirit dhe vajit të bërsive të ullirit”; të ligjit nr. 8691, datë 16.11.2000, “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”; të nenit 11, të ligjit nr. 17/2020, “Për produktet plehëruese”; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; të pikës 10, të VKM-së nr. 335, datë 6.6.2018, “Për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kritereve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar; të pikës 9, të VKM-së nr. 223, datë 13.4.2001, “Për vlerësimin cilësor të markave të cigareve të pranishme në tregun shqiptar”; të VKM-së nr. 515, datë 19.7.2006, “Për ristrukturimin e instituteve kërkimore shkencore në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit”; dhe të VKM-së nr. 432, datë 28.6.2006, “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore”, ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ministri i Financave

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr. 19, datë 22.11.2022, “Për tarifat e të ardhurave dytësore të aplikueshme nga institucionet vartëse të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

1. Pika 2, ndryshon si më poshtë:

“Tarifat e përcaktuara në këtë udhëzim, nuk aplikohen për analizat e kërkuara nga:

- Institucionet e varësisë së ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Aplikantët e regjistruar me emërtimet EOM (Emërtim Origjine i Mbrojtur), TGJM (Tregues Gjeografik i Mbrojtur); STG (Specialitet Tradicional i Garantuar), për një periudhë 5-vjeçare, nga momenti i regjistrimit në regjistër.”.

2. Pas pikës 2, shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“- Tarifa e përcaktuar në këtë udhëzim për aplikimet për certifikim për produktet EOM (Emërtim Origjine i Mbrojtur), TGJM (Tregues Gjeografik i Mbrojtur); STG (Specialitet Tradicional i Garantuar), nuk aplikohet për një periudhë 5-vjeçare, nga momenti i regjistrimit në regjistër.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

MINISTËR I FINANCEVE

Ervin Mete